



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.110/2016

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Nenad Lazić kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulamtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA, të dyjat me seli në Prishtinë, paraqitur kundër komisionarëve të vendvotimit 0316e/02d, për shkak të asistimit tek votuesit gjatë ditës së zgjedhjeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Drenasit të datës 04.12.2016, në seancën e panelit të mbajtur me 07.12.2016, mori këtë:

#### V E N D I M

**APROVOHET** si e bazuar ankesa Anr.110/2016 datë 05.12.2016 e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulamtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA, të dyjat me seli në Prishtinë, ashtu që Kryesuesit të Vendvotimit (VV) 0316e/02D Beqir Nika, me nr. të letërnjoftimit 2030220377 dhe anëtarëve të te njëjtit VV, Ilir Nika, me nr. të letërnjoftimit 2014740697, Fidaije Zogaj, me nr. të letërnjoftimit 1002044176 dhe Fehmi Berisha, me nr. të letërnjoftimit 1015705783, ju ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

#### A r s y e t i m

Me datën 05.12.2016 Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulamtuese (BIRN) dhe INTERNEËS KOSOVA ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se në vendvotimin 0316e/02d në shkollën "Xhevë Lladrovci" në fshatin Gllanasell të Drenasit një person shihet se si i ndihmon dy persona të ndryshëm për të votuar dhe se personat që kane asistuar në këtë qendër nuk janë evidentuar askund përkundër asaj se kishte shumë raste të tilla. Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 89 par 5 të LZP-së dhe se si dëshmi ka bashkangjitur një CD nga vendi i ngjarjes.

Parashtruesi i ankesës me parashtresën e datës 05.12.2016, ka bërë plotësimin e ankesës duke theksuar se komisionari përgjegjës lidhur me shkeljet e pretenduara si ankesë është Ilir Nika, komisioner në vendvotimin 0316e/02D nga subjekti politik PDK, e i cili kishte për detyrë kontrollimin e letërnjoftimeve dhe evidentimin e votuesve që ndihmonin personat që kishin nevojë për ndihmë.

PZAP-i, po ashtu e informoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për ankesën që është paraqitur dhe duke kërkuar nga KQZ që ta ofroj PZAP-it materialit zgjedhor-librin e votimit për vendvotimin 0316e/02d.

Brenda fatit të përcaktuar PZAP-it pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ-ja me nr 1225A/2016 të cilës përgjigje i ka bashkangjitur materialin zgjedhor – librin e votimit, për vendvotimin 0316e/02d.

PZAP-i me datën 06.12.2016 nëpërmjet telefonit zyrtar mori deklaratën edhe nga Ilir Nika komisionar nga subjekti politik PDK i dyshuar lidhur parrregullsitë e pretenduara nga pala ankuese, i cili në deklaratën e tij thekson se pretendimet e tilla se një person i gjinisë femërore i ka asistuar për dy persona te njëjtës gjini nuk janë të vërteta pasi që vendvotimin ku ka qene i caktuar për të shërbyer nuk ka vërejtur një rast të tillë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj pretendimet e palëve ne procedure dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se ankesa është e **bazuar** për këto arsye:

Neni 94 i LZP-së përcakton qartë se kryesuesi, anëtarët e KVV-së dhe vëzhguesit e akredituar të pranishëm lejohen të bëjnë shënime apo vërejtje në librin e votimit (librin e shënimeve në vendvotim) në të cilën shënohen ngjarjet që ndodhin në vendvotim.

PZAP-i vlerëson se pretendimi i parashtruesit të ankesës lidhur me mos evidentimin e personave që i kanë asistuar votuesit për të votuar është i qëndrueshëm sepse nga video incizimi i ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës, që gjendet në shkresat e lëndës, shihet qartë se si një person i gjinisë femërore i asiston dy persona respektivisht votuese, për të votuar, ndërsa në librin e votimit për rastin konkret nuk është evidentuar asnjë person se ka votuar gjegjësisht i ka asistuar votuesit për të votuar.

Lidhur pjesën e dispozitivit të këtij vendimi që ju është ndaluar e komisionereve të VV0316e/02D, pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), vendimi nga PZAP është marrë në bazë të

nenit 120 par.3, pika d), në të cilin parashihet së "Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve PZAP-i mundet. d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite", pasi që PZAP-i, ka konstatuar se asnjëri nga komisioneret duke e përfshirë edhe kryesin e VV0316e/02D, nuk e kanë ndërmarr asnjë veprim në ditën e votimit të datës 04.12.2016, lidhur me evitimin e shkeljeve, siç është pretenduar në ankesë.

Prandaj PZAP, duke u nisur nga arsyet e theksuar më lart, konform dispozitës ligjore të nenit 89 paragrafi 3 dhe 5 i LZP-së, në të cilën parashihe se një person mund ti asistoj vetëm një votuesi dhe jo disa votuesve, neni 94, 118 par. 1 dhe nenin 120 par.3 pika d) të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.110 /2016 më datën 07.12.2016.



d.v

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.